



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 26.12.2023.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin nëntor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 24, datë 23.03.2023.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Sang 1” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
6. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit dhe veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 218, datë 20.12.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Arsti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Arsti” me kapacitet të instaluar 3130 kW”.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe heqjen e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
10. Mbi monitorimin e të licencuarve në veprimtarinë e prodhimit, furnizimit dhe tregimit të energjisë elektrike, në lidhje me mbajtjen e llogarive të ndara dhe strukturën aktuale organizative.
11. Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitoare për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyera ndaj ERE-s.